**KËRKESË**
**Nr. 82/4, datë 31.5.2021**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për shpronësim, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 843, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Rruga lidhëse e Apolonisë"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në ARRSH, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 468,328 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë e treqind e njëzet e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
**Erlis Hereni**

**LISTA PARAPRAKE E PRONARIT, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 843, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'RRUGA LIDHËSE E APOLONISË'"**

| Në VKM-në nr. 843, datë 28.10.2020 | | | | | | | | | | Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 843, datë e 28.10.2020 | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor sipas VKM-së** | **Emër Atësi Mbiemër** | **ZK** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pasurisë** | **Sip. totale /m²** | **Sip. e shpronësuar/m²** | **Çmimi në lekë/m²** | **Vlera totale për shpronësim** | **Shënime** | **Nr. rendor sipas VKM-së** | **Emër Atësi Mbiemër** | **ZK** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pasurisë** | **Sip. totale /m²** | **Sip. e shpronësuar/m²** | **Çmimi në lekë/m²** | **Vlera totale për shpronësim** | **Shënime** |
| **15** | Vasil Lili Cuni | 3015 | 100/1 | Are | 4,929 | 216 | 269 | **58,105** | Konfirmuar nga ASHK | **15** | Vasil Lili Çuni | 3015 | 100/24 | Are | 5088 | 1957 | 269 | **526,433** | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| | **Vlera totale** | | | | **4,929.0** | **1,957** | | **58,105** | | | **Vlera totale** | | | | **5,088.0** | **1,957** | | **526,433** | |
| **Vlera shtesë në lekë që kërkohet për shpronësim 468,328 lekë** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

***Shënime. 1.*** *Për tokën "arë", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".*